

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Për t’u plotësuar
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e miratimit të RIAs nga KM.
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Jorgjeta Marko Jorgjeta.Marko@meki.gov.al Aviola Bani Aviola.Bani@meki.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i></p> <p>Problemi i evidentuar ndër vite qëndron në vështirësinë që has institucioni zbatues i legjislacionit të sigurimeve shoqërore në caktimin e pensionit për shkak të mungësës së dokumentacionit që vërtetojnë vjetërsinë në punë para vitit 1994 të personave që kanë punuar në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat bujqësore. Duke qenë se në shumë raste kërkuesit nuk kishin periudha kontributive pas vitit 1994, nuk plotësohej kushti minimal i periudhës së sigurimit, gjë që ka detyruar shumë qytetarë t’i drejtohen gjykatave me kërkesëpadi për njohjen e periudhave të padokumentuara</p>	

të para vitit 1994. Ky proces, i cili zgjat në kohë, ka shpenzime të mëdha, e shpesh të papërballueshme për qytetarët.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:

Objektivi në tërësi i këtij propozimi është njohja si periudhë e përgjithshme sigurimi për efekt pensioni, në sistemin e sigurimeve shoqërore, periudha e sigurimit në:

1. Institucionet dhe në ish-ndërmarrjet shtetërore deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7703/1993, datë 1.10.1993;
2. Ish-ndërmarrjet bujqësore deri më datën e hyrjes në fuqi të VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”, i ndryshuar dhe
3. Ish-kooperativat bujqësore deri më datë 19.7.1991, data e hyrjen në fuqi e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
4. Kjo politikë gjithashtu do të mundësojë njohjen sipëriudhë për personat e përmendur në pikat 1, 2 dhe 3:
 - a. Për pensione që nuk janë caktuar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pavarësisht datës së plotësimit të moshës për përfitim;
 - b. Për pensione kur kërkuesit i është caktuar pension nga sigurimet shoqërore, përpara datës së hyrjes në fuqi dhe janë në shqyrtim administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit dhe në Komisionin Qendror të Ankimit në ISSH, apo në proces gjykimi në gjykatë, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.

Aktualisht jemi në kushtet e mëposhtme:

Njohja si periudhë e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, referuar legjislacionit në fuqi, specifikisht:

1. Ligji nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”;
3. Rregullore nr. 1 datë 28/09/2021 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Referuar kësaj baze ligjore ekziston një hap fillestar për njohjen si periudhë sigurimi për efekt pensioni që është periudha e punësimit në disa ish kooperativa bujqësore, ku njohja e viteve të punës në mungesë të dokumentacionit bëhet pa pengesa procedurale dhe kosto shtesë. Por kjo bazë ligjore e kufizon shtrirjen e zbatimit vetëm në një numër të caktuar ish kooperativash bujqësore të përcaktuara në VKM nr. 432/2021, duke mos e zgjidhur problemin në tërësinë e vet dhe duke krijuar diskriminim mes përfituesve. Gjithashtu, kjo bazë ligjore nuk zgjerohet në përfitues të tjerë, që mbartin të njëjtat problematika, sic janë përfituesit që kanë punuar në ish institucionet dhe ndërmarrjet bujqësore si dhe ish ndërmarrjet bujqësore.

Nëse nuk do të ndërhyjmë do vazhdojmë të përballemi me të njëjtat problematika siç jemi përballur gjatë gjithë kësaj kohe.

Opsioni 1 (rregullator) – miratimi i ligjit me efekt retroaktiv

Hartimi dhe miratimi i një projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, me efekt prapaveprues.

Miratimi i ligjit me efekt prapaveprues, pra, të drejtat e përfitimit nga ky ligj shtrihen në kohë me prapaveprim, sjell jo vetëm mosbarazim në totalin e njohjes së viteve, por sjell edhe efekte financiare të mëdha edhe të paparashikueshme.

Nëse të drejtat e përfitimit nga ky ligj do të shtrihen në kohë me prapaveprim, përbën një kosto mjaft të lartë. Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues vetëm nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri në vitin 2023, do të kemi një kosto minimale të shtuar vjetore prej 6.9 mld lekë në vit. Nëse marrim në konsideratë edhe kohën mesatare të gëzimit të pensionit, mesatarisht për 15 vite, kjo kosto del shumë herë më e lartë.

Në llogaritje, nëse përfitues nga ky projekt ligj do të përfshiheshin edhe kategoria që kanë dalë në pension para janarit 2015, kostot financiare janë shumë herë më të larta se këto që analizuam më sipër.

Përgjithësisht, periudhat e vjetërsisë në punë me problematika, për pensionet e caktuara ndër vite janë njohur me vendime gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë ky projekt ligj nuk ka efekte në masën e tyre.

Opsioni 2 (rregullator, i preferuar)

Hartimi dhe miratimi i një projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime mbi përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Qytetarët nuk do i drejtohen më gjykatave me kërkesë padi për njohjen e ketyre periudhave, i cili është një proces që zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha e shpesh të papërbalueshme për qytetarët.

Në parashikimin vjetor në buxhetin e pensioneve do të rezultojë një kosto e shtuar për çdo vit si rezultat i numrit më të madh të pensioneve si dhe masave më të larta të pensioneve për kategoritë përfituese nga ky ligj.

Gjithashtu në koncept të ligjit, me efekt nga hyrja në fuqi, rezulton një kosto mesatare e shtuar për vitin e parë në vlerën 40 milion lekë . Gjithashtu në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është 600 mln lekë.

Në vitin e dytë në zbatim kosto e shtuar vjetore si efekt i këtij ligji me një vjetërsi maksimale sipas kategorive në 15 vjet, është në vlerën 37 mln lekë, ku me një kohë gëzimi pensioni prej 15 vitesh, kosto për këta përfitues është 555 mln lekë.

Në vitet në vazhdimësi kosto e shtuar vit pas viti për zbatimin e ligjit vjen me ritëm rënieje deri në shuarje totale për një periudhë maksimale prej 16 vitesh. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezulton 5 mld lekë.

Miratimi i këtij projekligji do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime mbi përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Qytetarët nuk do i drejtohen më gjykatave me kërkesë padi për njohjen e ketyre periudhave, i cili është një proces që zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha e shpesh të papërbalueshme për qytetarët.

Në këto gjykime qytetarët ngarkohen me barrë prove dhe detyrohen të provojnë shkaqet për të cilat, akti që vërteton periudhat përkatëse nuk mund të merret ose është e pamundur të ribëhet përsëri, si dhe provat përmes të cilave do të provohen periudhat përkatëse, të cilat janë kryesisht prova me dëshmitarë, të cilët në raste të caktuara nuk mund të gjenden, mund të kenë ndërruar jetë ose nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është opsioni 2.

Qeveria:

- Ndikimet që do të mundësonte miratimi i këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Rritja e mirëqenies së pensionistëve nëpërmjet përfitimit të pensioneve më të larta,

2. Zbutja e nivelit të varfërisë në radhët e moshës së tretë,
3. Injektimi në ekonomi si rezultat i rritjes së konsumit nga pensionistët.
4. Njohja e të drejtave të fituara, por të padokumentuara,
5. Shpenzime më të ulta administrative si rrjedhojë e eliminimit të kostove dhe procedurave të shtuara për njohjen e të drejtave të fituara, por të padokumentuara.

Ndikime jo të drejtpërdrejta: Miratimi i këtij projektligji do të ndikonte në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe kryesisht rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për dhënien e përfitimeve .

Subjektet ekonomike: nuk ka ndikim

Punëmarrësit: nuk ka ndikim

Pala përfituese:

Miratimi i këtij projektligji do të mundësonte:

1. Njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht,
2. Eliminimin e shpenzimeve gjyqësore për përfituesit,
3. Përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social,
4. Shmangien e proceseve gjyqësore dhe ankimimeve në komisionet rajonale dhe qendrore të ISSH.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 2, Hartimi dhe miratimi i një projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, pasi mundëson:

-Kosto më të ulët: Bazuar në analizën kosto përfitim.

Opsioni 1

Në aspektin financiar nëse të drejtat e përfitimit nga ky do të shtrihen në kohë me prapaveprim, përbën një kosto mjaft të lartë. Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues vetëm nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri në vitin 2023:

1. Për personat që kanë punuar në ish kooperativat bujqësore, rezulton një kosto vjetore e shtuar për 7,500 pensione në vlerën 1.7 mld lekë në vit;

2. Për personat që kanë punuar në ish ndërmarrjet bujqësore dhe ndërmarrje shtetërorerezulton një kosto vjetore e shtuar për 22,000 pensione, në vlerë 5.2 mld lekë

Pra, kemi një kosto minimale të shtuar vjetore prej 6.9 mld lekë në vit. Nëse marrim në konsideratë edhe kohën mesatare të gëzimit të pensionit, mesatarisht për 15 vite, kjo kosto del shumë herë më e lartë.

Në llogaritje, nëse përfitues nga ky projekt ligj do të përfshiheshin edhe kategoria që kanë dalë në pension para janarit 2015, kostot financiare janë shumë herë më të larta se këto që analizuam më sipër.

Opsioni 2

Në aspektin financiar nëse të drejtat e përfitimit nga ky ligj do të shtrihen me efekt nga hyrja në fuqi, kostoja financiare ka efekte më të ulëta. Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues llogaritet një mesatare prej 40.000 pensione të reja në vit, me vlerë 40 mln lekë për vitin e parë.

Gjithashtu, në vitin e parë, në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është 606 mln lekë.

Në vitin e dytë në zbatim kosto e shtuar vjetore si efekt i këtij ligji me një vjetërsi maksimale sipas kategorive në 15 vjet, është në vlerën 37 mln lekë, ku me një kohë gëzimi pensioni prej 15 vitesh, kosto për këta përfitues është 555 mln lekë.

Në vitet në vazhdim kosto e shtuar vjetore për zbatimin e ligjit vjen me ritëm rënieje deri në shuarje totale për një periudhë maksimale prej 16 vitesh. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezulton 5 mld lekë.

Opsioni 1

	viti 1	viti 2	Kosto totale
Kosto vjetore e shtuar (përfituesit 2015-2023)	6,900,000,000	6,900,000,000	
Për përfituesit nga 2015 gëzimi i pensionit 8 vite			55,200,000,000
Kosto totale e ligjit për përfituesit e rinj			5,000,000,000
Kosto totale e ligjit			60,200,000,000

Opsioni 2

	viti 1	viti 2	Kosto për përfituesit e vitit / gëzimi i pensionit 15 vite
Kosto e shtuar	40,000,000	40,000,000	600,000,000
		37,000,000	555,000,000

Kosto totale nga zbatimi i ligjit			5,000,000,000
-----------------------------------	--	--	----------------------

Opsioni 2 është i preferuari.

- Realizimi i objektivave: Do të bëjë të mundur realizimin e objektivave të Qeverisë në fushën e politikave sociale. Opsioni 2 do të bëjë të mundur zbatimin e legjislacionit të sigurimeve shoqërore duke përmirësuar kushtet e jetesës së pensionistëve si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social, duke ndikuar mirëqenien e përgjithshme të pensionistëve.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

viti 1	viti 2	viti 3	Kosto totale
40,000,000	40,000,000	40,000,000	120,000,000
	37,000,000	37,000,000	74,000,000
		35,000,000	35,000,000
Totali			229,000,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ky projektligji është iniciuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe MEKI. MEKI e konsultoi së brendshmi me Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhmërisë. Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe do të dërgohet për konsultim publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Ngarkohen MEKI dhe Këshilli i Ministrave për miratimin e këtij projektligji.

Ngarkohet për zbatimin e këtij akti MBZHR, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë listën e ish-kooperativave bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore.

Ngarkohet ISSH që brenda 1 muaji nga miratimi i listës së ish-kooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore nga MBZHR, të nxjerr rregulloren për përcaktimin e procedurës dhe rregullave për zbatim si dhe zbatimin e tij në vijimësi.

Indikator i suksesit të politikës është:

1. njohja e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë, paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht,
2. eliminimi i shpenzimeve mbi përfituesit
3. përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

4. shmangia e proceseve gjyqësore dhe ankimimeve në komisionet rajonale dhe qendrore të ISSH

Në terma më afatshkurtër, politika do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet numrit të pensioneve të rregulluara që janë në proces gjyqësor ose ankimim administrativ vendor/qendror si dhe numrit të pensioneve të reja

Në terma afatgjatë, politika i shuan efektet pas 16 vitesh maksimalisht.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Problematika e trashëguar nga e kaluara në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit nga institucionet shtetërore, ish-ndërmarrjet shtetërore, ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, ka bërë që shumë qytetarë t'i drejtohen dyerve të gjykatave, komisioneve rajonale dhe qendrore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Grumbullimi i dokumentacionit të vjetërsisë në punë para vitit 1994, të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve shtetërore, ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave bujqësore, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 22.07.1998 “Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish-kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre, ose janë në procesin e mbylljes”, sistemimi, administrimi dhe shfrytëzimi i tij, në strukturat arkivore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 19.11.2004 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, të ndryshuar, evidentoi problematika të konsiderueshme, si: mungesë e plotë të dhënash, të dhëna të pjesshme, të korigjuara, të fshira, identitete të pasakta, fletë të dëmtuara, mungesë dokumentacioni për subjekte të caktuara etj.

Është bërë një përpjekje fillestare, e fragmentarizuar dhe e lokalizuar që nuk e zgjidh problemin tërësor, nëpërmjet bazes ligjore të mëposhtme:

1. Ligji nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”;
3. Rregullore nr. 1 datë 28/09/2021 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Përfituesit përcaktohen në bazë të listës së ëish kooperativave bujqësore, janë shumë të pakta në numër këto kooperativa dhe çështja ngelet vetëm te to pa u përhapur në institucione të tjera që janë po aq problematike për nga disponimi i dokumentacionit të nevojshëm që vërteton vjetërsinë në punë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Nevoja për ndërhyrje e qeverisë lindi nga fakti se në kuadrin ligjor ekzistues, është evidente pamundësia për grumbullimin, sistemimin, administrimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë para vitit 1994, të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve shtetërore, ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave bujqësore, në strukturat arkivore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 19.11.2004 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, të ndryshuar, U evidentuan problematika të konsiderueshme, si: mungesë e plotë të dhënash, të dhëna të pjesshme, të korrigjuara, të fshira, identitete të pasakta, fletë të dëmtuara, mungesë dokumentacioni për subjekte të caktuara.

Për shkak të problematikave të sipërpërmendura dhe kompetencave të kufizuara të strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, periudha të konsiderueshme vjetërsie në punë, nuk janë konfirmuar dhe nuk janë njohur administrativisht, me pasojë refuzimin e kërkesave për caktim pensioni, sepse duke qenë se në shumë raste kërkesit nuk kishin periudha kontributive pas vitit 1994, nuk plotësohej kushti minimal i periudhës së sigurimit, gjë që ka detyruar shumë qytetarë t’i drejtohen gjykatave me kërkesëpadi për njohjen e këtyre periudhave, proces i cili zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha, e shpesh të papërballueshme.

Miratimi i këtij projektligji, do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, siç ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime për përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të pakten sa masa e pensionit social.

Grupet e Prekura:

Për problematikat e evidentuar mësipër si grupe të prekura janë identifikuar:

Qeveria/Institucionet Shtetërore: për të gjitha problematikat e sipërmendura do të nevojitet përfshirja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe

Inovacionit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratohet listën e ish kooperativave bujqësore dhe ish ndërmarrjeve bujqësore.

ISSH brenda 1 muaji nga miratimi i listës së ish-kooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore nga MBZHR, nxjerr rregulloren për përcaktimin e procedurës dhe rregullave për zbatim si dhe zbatimin e tij në vijimësi.

Biznesi/subjektet ekonomike: nuk ka ndikim

Qytetarët: njohja e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, eliminimi i shpenzimeve mbi përfituesit, përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social, shmangia e proceseve gjyqësore dhe ankimimeve në komisionet rajonale dhe qendrore të ISSH

Arsyeja e ndërhyrjes

f) Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.

g) Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.

h) Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

i) Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Qeveria ka vendosur të ndërhyjë për të zgjidhur përfundimisht problematikën e njohjes së viteve të punës për përfituesit që kanë punuar në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, para vitit 1994.

Ndërhyrja synon rregullimin për njohjen si periudhë të përgjithshme sigurimi për pensione të pacaktuara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji si dhe atyre që janë në shqyrtim administrativ apo gjyqësor.

Në këto kushte, projektligji, përcakton efektin nga momenti i hyrjes në fuqi dhe sjell zgjidhjen përfundimtare të njohjes së periudhave të vjetërsisë në punë, për kategorinë e personave që nuk ju konfirmohet nga dokumentacioni i vjetërsisë në punë i subjekteve, ul në mënyrë të ndjeshme proceset gjyqësore dhe ju siguron përfituesve të ardhura, për të paktën 15 vite sigurimi, që në përgjithësi janë sa një pension social.

Gjithsesi, është parashikuar që në rastet kur në kërkesat për caktim pensioni, deklarohen periudha në subjekte, detyra dhe funksione specifike, llogaritja e të cilave sjell efekte pozitive në masën e pensionit, me dakordësinë e kërkuesit, të ndiqet procedura ligjore në fuqi për shqyrtimin, vlerësimin dhe njohjen e tyre për efekt përfitimi në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Kjo ndërhyrje është në përputhje dhe sinkronizohet me politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale të Qeverisë.

Gjithashtu kjo ndërhyrje mbështet kuadrin e politikave ekonomike dhe financiare (MEKI, MF), në zbatim të politikave në nivel qendror të sigurimeve shoqërore (ISSH), edhe të zbatimit të politikave në nivel vendor (zyrat Rajonale të ISSH).

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë: Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka evidentuar të dhënat e vjetërsive për përfituesit të cilët janë objekt i trajtimit sipas këtij ligji. Nëpërmjet këtij verifikimi paraprak është bërë e mundur llogaritja e efektit buxhetor si rezultat i zbatimit të këtij ligji. Gjithashtu, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji, në kushtet e evidentimit të problematikave, zbatimi i tij bëhet më i lehtë.

Objektivi i politikës

Objektivi që synohet të arrihet nëpërmjet miratimit të këtij projektligji, është njohja e periudhave të punës në institucionet dhe në ish-ndërmarrjet shtetërore deri më datë 1.10.1993, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7703/1993; në ish-ndërmarrjet bujqësore deri më datën e hyrjes në fuqi të VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”, i ndryshuar dhe në ish-kooperativat bujqësore deri më datë 19.7.1991, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

Nëpërmjet projektligjit synohet:

1. Njohja si periudhë e përgjithshme sigurimi për efekt pensioni nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe në institucione shtetërore:
 - a) nga mosha 18 vjeç, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) nga data e përfundimit të shkollës së lartë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Njohja si periudhë e përgjithshme sigurimi në ish-Kooperativë Bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, nga mosha 18 vjeç, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.
3. Njohja si periudhë e përgjithshme sigurimi në ish-Ndërmarrjet Bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, nga mosha 18 vjeç, por jo më herët se data e krijimit të ish-Ndërmarrjes Bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të vendimit nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”.

Pikat 1, 2 dhe 3, të këtij projektligji, parashikojnë njohjen si periudhë e përgjithshme sigurimi, nga mosha 18 vjeç, duke parashikuar që në secilin subjekt të njihet vjetërsi pune, që së bashku me periudha sigurimi nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, të plotësohet të paktën kushti minimal i periudhës së sigurimit për përfitim pensioni pleqërie (15 vite), konkretisht:

Burra:

Mosha për pension pleqërie 2024	Periudha e njohjes sipas projektligjit			
	Pika	Fillimi (18 vjeç)	Mbarimi	Gjithsej (rreth)

65 vjeç	1	1977	1.10.1993	16 vite
Vitlindja	2	1977	19.7.1991	14 vite
1959	3	1977	17.10.1992	15 vite

Gra:

Moshë për pension pleqërie 2024	Periudha e njohjes sipas projektligjit			
	Pika	Fillimi (18 vjeç)	Mbarimi	Gjithsej (rreth)
61 vjeç e 8 muaj Vitlindja 1962	1	1980	1.10.1993	13 vite
	2	1980	19.7.1991	11 vite
	3	1980	17.10.1992	12 vite

5. Kjo politikë gjithashtu do të mundësojë njohjen si periudhë për personat e përmendur në pikat 1, 2 dhe 3:
- Për pensione që nuk janë caktuar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pavarësisht datës së plotësimit të moshës për përfitim;
 - Për pensione kur kërkuesit i është caktuar pension nga sigurimet shoqërore, përpara datës së hyrjes në fuqi dhe janë në shqyrtim administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit dhe në Komisionin Qendror të Ankimit në ISSH, apo në proces gjykimi në gjykatë, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 (status quo): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re.

Aktualisht jemi në kushtet e mëposhtme:

Njohja si periudhë e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, referuar legjislacionit në fuqi, specifikisht:

- Ligji nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”;
- Rregullore nr. 1 datë 28/09/2021 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Referuar kësaj baze ligjore ekziston një hap fillestar për njohjen si periudhë sigurimi për efekt pensioni që është periudha e punësimit në disa ish kooperativa bujqësore, ku njohja e viteve të

punës në mungesë të dokumentacionit bëhet pa pengesa procedurale dhe kosto shtesë. Por kjo bazë ligjore e kufizon shtrirjen e zbatimit vetëm në një numër të caktuar ish kooperativash bujqësore të përcaktuara në VKM nr. 432/2021, duke mos e zgjidhur problemin në tërësinë e vet dhe duke krijuar diskriminim mes përfituesve. Gjithashtu, kjo bazë ligjore nuk zgjerohet në përfitues të tjerë, që mbartin të njëjtat problematika, sic janë përfituesit që kanë punuar në ish institucionet dhe ndërmarrjet bujqësore si dhe ish ndërmarrjet bujqësore.

Nëse nuk do të ndërhyjmë do vazhdojmë të përballemi me të njëjtat problematika siç jemi përballur gjatë gjithë kësaj kohe.

Opsioni 1 (rregullator) – miratimi i ligjit me efekt retroaktiv

Hartimi dhe miratimi i një projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, me efekt prapaveprues.

Miratimi i ligjit me efekt prapaveprues, pra, të drejtat e përfitimit nga ky ligj shtrihen në kohë me prapaveprim, sjell jo vetëm mosbarazim në totalin e njohjes së viteve, por sjell edhe efekte financiare të mëdha edhe të paparashikueshme.

Nëse të drejtat e përfitimit nga ky ligj do të shtrihen në kohë me prapaveprim, përbën një kosto mjaft të lartë. Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues vetëm nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri në vitin 2023, do të kemi një kosto minimale të shtuar vjetore prej 6.9 mld lekë në vit. Nëse marrim në konsideratë edhe kohën mesatare të gëzimit të pensionit, mesatarisht për 15 vite, kjo kosto del shumë herë më e lartë.

Në llogaritje, nëse përfitues nga ky projekt ligj do të përfshiheshin edhe kategoria që kanë dalë në pension para janarit 2015, kostot financiare janë shumë herë më të larta se këto që analizuam më sipër.

Përgjithësisht, periudhat e vjetërsisë në punë me problematika, për pensionet e caktuara ndër vite janë njohur me vendime gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë ky projekt ligj nuk ka efekte në masën e tyre.

Opsioni 2 (rregullator, i preferuar)

Hartimi dhe miratimi i një projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime mbi përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Qytetarët nuk do i drejtohen më gjykatave me kërkesë padi për njohjen e ketyre periudhave, i cili është një proces që zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha e shpesh të papërbalueshme për qytetarët.

Në parashikimin vjetor në buxhetin e pensioneve do të rezultojë një kosto e shtuar për çdo vit si rezultat i numrit më të madh të pensioneve si dhe masave më të larta të pensioneve për kategoritë përfituese nga ky ligj.

Gjithashtu, në vitin e parë, kosto e shtuar vjetore për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është 40 mln lekë.

Në vitin e dytë në zbatim kosto e shtuar vjetore për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është 37 mln lekë.

Në vitet në vazhdimësi kosto e shtuar vjetore për zbatimin e ligjit vjen me ritëm rënieje deri në shuarje totale për një periudhë maksimale prej 16 vitesh. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezulton 5 mld lekë.

Miratimi i këtij projekligji do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime mbi përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Qytetarët nuk do i drejtohen më gjykatave me kërkesë padi për njohjen e ketyre periudhave, i cili është një proces që zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha e shpesh të papërballueshme për qytetarët.

Në këto gjyqe qytetarët ngarkohen me barrë prove dhe detyrohen të provojnë shkaqet për të cilat, akti që vërteton periudhat përkatëse nuk mund të merret ose është e pamundur të ribëhet përsëri, si dhe provat përmes të cilave do të provohen periudhat përkatëse, të cilat janë kryesisht prova me dëshmitarë, të cilët në raste të caktuara nuk mund të gjenden, mund të kenë ndrruar jetë ose nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt. Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

A. Grupet e prekura nga kjo politikë janë:

Qeveria: Insitucionet e përfshira janë përmendur në pjesën e parë të kësaj Analizë të Vlerësimit të Ndikimit.

Qeveria:

-Ndikimet që do të mundësonte miratimi i këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Rritja e mirëqenies së pensionistëve nëpërmjet përfitimit të pensioneve më të larta,
2. Zbutja e nivelit të varfërisë në radhët e moshës së tretë,
3. Injektivimi në ekonomi si rezultat i rritjes së konsumit nga pensionistët.
4. Njohja e të drejtave të fituara, por të padokumentuara,
5. Shpenzime më të ulta administrative si rrjedhojë e eliminimit të kostove dhe procedurave të shtuara për njohjen e të drejtave të fituara, por të padokumentuara.

Ndikime jo të drejtpërdrejta: Miratimi i këtij projektligji do të ndikonte në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe kryesisht rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për dhënien e përfitimeve .

Subjektet ekonomike: nuk ka ndikim

Punëmarrësit: nuk ka ndikim

Pala përfituese:

Miratimi i këtij projektligji do të mundësonte:

1. njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht,
2. Eliminimin e shpenzimeve gjyqësore për përfituesit,
3. përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social,
4. shmangien e proceseve gjyqësore dhe ankimimeve në komisionet rajonale dhe qendrore të ISSH.

B. Metodologjia e përdorur për opsionin 1

Për analizën e kostove do të përdorim këto njësi matëse të cilat janë:

Për analizën e kostove do të përdorim këto njësi matëse të cilat janë:

Vitet e munguara, numri i pensioneve të reja në vit, vjetërsi maksimale prej 38 vitesh në vitin 2023, pension mesatar 20,000 lekë, 15 vite kohë mesatare e gëzimit të pensionit.

Kështu kosto do të jetë:

Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri më vitin 2023 për personat në pension me vjetërsi pune në ish-KB dhe ish ndërmarrje shtetërore rezultojnë 1,112,000 vite të munguara në përlllogaritje me një vlerësim vjetërsie prej 16 vite për këto kategori personash dhe me numrin e pensioneve të reja në këtë hark kohor rezultojnë për kategorinë e periudhave për efekt pensioni para datës 01.10.1993 rreth 12 përqind vjetërsi e munguar.

Nga ky 12 përqind e vjetërsisë së munguar, vjetërsitë në ish KB zënë peshën 25.6 përqind dhe vjetërsitë për ish ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore zënë peshën prej 74.4 përqind.

Sa më sipër në koncept të projektligjit, me efekt nga hyrja në fuqi, me një mesatare prej 40,000 pensione të reja në vit, me vjetërsinë maksimale sipas kategorive prej 16 vjetësh, me 12% vite të munguara rezultojnë 76,800 vite të munguara për vitin e parë të zbatimit. Këto vite të munguara në llogaritje me një vjetërsi të plotë prej 38 vitesh me një pension mesatar 20,000 lekë rezultojnë një kosto vjetore e shtuar për 2,021 pensione, në vlerën 40 milion lekë në vitin e parë. Gjithashtu në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është 600 milion lekë.

Kjo kosto e shtuar është përlllogaritje maksimale pasi përlllogaritjet janë realizuar me vjetërsinë maksimale para 01.10.1993 nga mosha 18 vjec prej 16 vitesh ndërkohë vjetërsia minimale për kategoritë përfituese nga ky ligj për kategorinë femra është 11 vite.

Në vitin e dytë të zbatim kosto e shtuar vjetore si efekt i këtij ligji me një vjetërsi maksimale sipas kategorive në 15 vjet , është në vlerën 37 milion lekë, ku me një kohë gëzimi pensioni prej 15 vitesh, kosto për këta përfitues është 555 milion lekë.

Në vitet në vazhdimësi kosto e shtuar vjetore për zbatim të ligjit vjen me ritëm rëniesje deri në shuarje totale për një periudhë maksimale prej 16 vjetësh. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezulton në 5 miliard lekë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është **Opsioni 2**. Kjo do të ishte rruga më e mirë për të arritur objektivat, pasi do të zgjidhej përfundimisht problemi i qytetarëve për njohjen e viteve të punës në kushtet kur nuk është ruajtur dokumentacioni ose ai ekzistues nuk e provon dot administrativisht këtë vjetërsi. Qytetarët nuk do i drejtohen më gjykatave me kërkesë padi për njohjen e ketyre periudhave, i cili është një proces që zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha e shpesh të papërbalueshme për qytetarët dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Ky vlerësim rezulton edhe nga analiza me shumë kritere, pasqyruar më poshtë si vijon:

Analiza më shumë kritere

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 – status quo-ja dhe mosbërja e ndryshimeve ligjore, duke pritur që situata të vetërregullohet, pa ndërhyrjen e pushtetit legjislativ.

Opsioni 2 – (i preferuar) rregullator- Miratimi i ligjit

Opsioni 1: rregullator – Miratimi i ligjit me efekt retroaktiv

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

1. Efikasiteti i politikave në kuadër të mbrojtjes sociale;
2. Harmonizimi i këtij ligji me kuadrin rregullator në fuqi;
3. Efikasiteti i masave të ndërmarra në drejtim të garantimit të të drejtave të konstatuara;
4. Efikasiteti i programeve të tjera shtetërore në kuadër të politikave sociale;
5. Kosto-efektiviteti.

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Efikasiteti i politikave në kuadër të mbrojtjes sociale	5	2 (10)	5 (15)	3 (25)
Harmonizimi i këtij ligji me kuadrin rregullator në fuqi	4	0 (0)	4 (0)	4 (16)
Efikasiteti i masave të ndërmarra në drejtim të garantimit të të drejtave të konstatuara	5	1 (5)	5 (10)	5(25)
Efikasiteti i programeve të tjera shtetërore në kuadër të politikave sociale	3	1 (3)	3 (6)	3(9)
Kosto-efektiviteti	5	1 (5)	4 (10)	4(20)
Pikët	-	23	41	95

Analiza me shumë kritere tregon se opsioni 2, miratimi i projektligjit “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, është vlerësuar me më shumë pikë, për këtë arsye është përzgjedhur si opsion i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

MEKI, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur janë si vijojnë: Ankimimet e qytetarëve të cilët i kanë përfituar të drejtat për pension para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Si masa për zbatimin e këtij opsioni, renditen si më poshtë vijon:

- Hartimi i listës së ish kooperativave Bujqësore nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Hartimi i Udhëzimit teknik nga ISSH për zbatimin e këtij ligji.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si ministria përgjegjëse për çështjet e politikave të sigurimeve shoqërore, e cila mbështet funksionimin efektiv të Institutit të Sigurimeve Shoqërore si dhe monitoron objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të ISSH dhe treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së tij, do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e arritjes së treguesve pas miratimit të politikës.

Në terma më afatshkurtër, politika do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme (12-mujore) nëpërmjet raporteve të performancës.

Disa prej treguesve që do të shërbejnë për të matur arritjen e objektivave janë:

- 1- Numri i çështjeve të zgjidhura nga rastet që janë në proces gjyqësor;
- 2- Numri i çështjeve të zgjidhura nga rastet që janë në ankimim administrativ vendor/qendror;
- 3- Numri i pënsioneve të reja të lidhura.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë	40,000,000	37,000,000	37,000,000	35,000,000	33,000,000	31,000,000	29,000,000	27,000,000	24,000,000	22,000,000
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										

Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni 1

	viti 1	viti 2	Kosto totale
Kosto vjetore e shtuar (perfituesit 2015-2023)	6,900,000,000	6,900,000,000	
Për përfituesit nga 2015 gëzimi i pensionit 8 vite			55,200,000,000
Kosto totale e ligjit për përfituesit e rinj			5,000,000,000
Kosto totale e ligjit			60,200,000,000

Opsioni 2

	viti 1	viti 2	Kosto për përfituesit e vitit / gëzimi i pensionit 15 vite
Kosto e shtuar	40,000,000	40,000,000	600,000,000
		37,000,000	555,000,000
Kosto totale nga zbatimi i ligji			5,000,000,000